

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË RREGULLATIVËS NË HIJE

–
RAPORT PËR VNR-
NË E LIGJIT PËR
INSPEKTORATIN
SHTETËROR PËR
PËRDORIMIN E
GJUHËVE –
ME FOKUS NË
PROCESIN E
KONSULTIMEVE

–
DHEJTOR, 2019



VLERËSIMI I NDIKIMIT TË RREGULLATIVËS NË HIJE

-

RAPORT PËR VNR-NË E LIGJIT PËR INSPEKTORATIN SHTETËROR PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE – ME FOKUS NË PROCESIN E KONSULTIMEVE

-

DHJETOR, 2019

Botues: Institutit për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup
Qendra për Analiza Ekonomike (CEA)

Përkthim: Litra

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:

<https://idsos.org.mk/mk/portfolio/vleresimi-i-ndikimit-te-rregullatives-ne-hije-raport-per-vnr-ne-e-ligjit-per-inspektoratin-shteteror-per-perdorimin-e-gjuheve-me-fokus-ne-procesin-e-konsultimeve/>

Disklejmer

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian, në kuadër të projektit Vlerësimi i ndikësës së rregullativës nën hije: Promovimi i krijimit të politikave të bazuara në dëshmi. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” dhe e “Qendrës për analiza ekonomike” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Unionit Evropian.

1. Hyrje

Në drejtim të avancimit të procesit Instituti i Demokracisë „Societas Civilis“ – Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Analiza Ekonomike (QAE) realizojnë projektin „Vlerësimi i ndikimit të rregullativës në hije: Promovimi i krijimit të politikave të bazuara në fakte në Maqedoni“ ose shkurt, „VNR në hije“. Projekti realizohet për të kryer analizën e procesit për VNR në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe rritjen e mundësive që, në të, të përfshihen edhe organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet rrjetëzimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të tyre.

Në këtë kuptim, ideja është që të rritet vetëdija për efektet nga ligjet, si dhe të iniciohet trysni nga ana e grupeve më të gjera në proceset e krijimit të ligjeve në të cilat pjesën thelbësore duhet ta kenë analizat dhe diskutimet e informuara.

2. RIA and the consultation process¹

Procesi i vlerësimit të ndikimit të rregullativës përbën mjet me qëllim themelor sjelljen e politikave të bazuara në fakte me shqyrtimin e kujdesshëm të ndikimeve potenciale të cilat do të dalin si rezultat i rregullimit të ndikimeve potenciale ose derregullimit në një fushë të caktuar.² Në këtë proces të ndërlikuar, një nga komponentët kryesorë është komponenti konsultues i VNR-së dhe mundësia për përfshirjen e palëve të interesuara në krijimin e zgjidhjeve ligjore. Përveç vlerës praktikave të vetë konsultimeve, të njëjtat janë thelbësore për krijimin e politikave në mënyrë transparente dhe të hapur.³

Është e rëndësishme të përmendet se konsultimet janë pjesë e një tërësie më të gjerë të mekanizmave të demokracisë debatuuese dhe si e tillë është komplementare me një varg procesesh të parashikuara, të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (QRMV) duhet t'i zbatojë. Sipas parimit të proporcionalitetit, volumi dhe thellësia e konsultimeve duhet të korrespondojë me madhësinë e rregullimit ose derregullimit të propozuar. Gjatë procesit të VNR-së, konsultimet në VNR ndodhin në tri raste. Në rastin e parë gjatë procesit të analizës fillestare të gjendjes dhe përcaktimit të qëllimeve të procesit të rregullimit ose derregullimit. Pastaj, palët e interesuara konsultohen gjatë analizës së ndikimeve sociale dhe ekonomike të çdo opsioni dhe përcaktimin e zgjidhjes optimale. Në fund, pas shpalljes së draft-raportit të vlerësimit, realizohet konsultimi i Regjistrit të Vetëm Elektronik Kombëtar të Dispozitave (REKD) ku draft-ligji është shpallur për komente nga palët e interesuara.⁴

¹ Marko Panovski dhe Jane Dimeski, Vendorsja dhe sfidat e procesit konsultues gjatë VNR-së . IDSCS, Shkup. Në dispozicion në: <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2018/11/thjeshtezim-i-sfida-te-procesit-konsultues-gjate-PVRMKD.pdf>

² Për më shumë informacione për VNR shiko „Manual për vlerësimin e ndikimit të rregullativës”. MSHIA, tetor 2013. Në dispozicion në: http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/Priracnik%20za%20PVR2_mk.pdf

³ Transparenca dhe hapja si cilësi të procesit të VNR-së janë theksuar edhe në vetë Metodologjinë për VNR.

⁴ Akte që rregullojnë materien për vlerësimin e ndikimit të rregullativës. MSHIA, shtator 2013. Në dispozicion në 2013. http://www.mio.gov.mk/files/pdf/Akti_PVR_1mk.pdf

Vendosja e procesit të konsultimit me palët e interesuara

Konsultimi i palëve të interesuara në VNR është përshkruar në shumicën e akteve ligjore, nënligjore të cilat rregullojnë procesin e tërësishëm të VNR-së. Shtrirja e përdorimit të VNR-së është përcaktuar në Rregulloren për punë të VRSM⁵ përderisa detalet e procesit janë përfshirë në Metodologjinë e vlerësimit të ndikimit të rregullativës.⁶ Në mënyrë plotësuese, si akte nënligjore të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme të VNR-së gjenden edhe Udhëzimi për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës dhe Vendimi për formën dhe përmbajtjen e raportit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës⁷.

Rregullorja për punë e VRSM-së, në nenin 68-a rregullon obligimin e ministrisë që në faqen e vet të internetit dhe në Regjistrin e Vetëm Kombëtar të Dispozitave t'i shpallin propozimet për sjelljen e ligjit, draftet dhe propozimet e ligjeve përveç rastit kur e njëjta nuk është përcaktuar më ndryshe.⁸ Me këtë nen mundësohet çdo palë e interesuar të depozitojë mendime, vërejtje dhe propozime në një afat kohor prej 20 ditësh nga dita e shpalljes.⁹ Në mënyrë plotësuese, ky nen obligon ministrinë të raportet për VNR të shpallin pasqyrën e mendimeve të marra, si dhe arsyet për mospranimin e disa mendimeve të caktuara.

Metodologjia për VNR, gjithashtu, përcakton edhe rolin e Koordinatorit për VNR në ministri. Në lidhje me procesin e konsultimit, koordinatori siguron mbështetje dhe këshilla përveç të tjerash edhe për konsultimet për VNR.

⁵ Gazeta Zyrtare e RM-së 38/2001 – 113/2017

⁶ Gazeta Zyrtare e RM-së 107/2013, стр. 21. fq. 21. Me sjelljen e Metodologjisë për NVR në vitin 2013, u shfuqizua Metodologjia për NVR e vitit 2009 (Gazeta Zyrtare e RM-së 66/2009)

⁷ Gazeta Zyrtare e RM-së 106/2013

⁸ NVR-ja nuk zbatohet për ligjet miratimi i të cilave propozohet me procedurë urgjente, ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjet me të cilat kryhet përshtatja terminologjike me ligjet e tjera, propozim-Buxheti i RM-së dhe Ligji për Ekzekutimin e Buxhetit të RM-së.

⁹ Më parë, afati i fundit për dorëzimin e mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve ishte 10 ditë. I njëjti u zgjat për 20 ditë me vendim të Qeverisë së RM-së më 17 gusht 2017 (Gazeta Zyrtare e RM-së 113/2017).

Nga ana tjetër, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA) është e obliguar të sigurojë konsultime efikase me palët e interesuara nëpërmjet përmirësimit të procesit të REKD-së.

Metodologjia për VNR përcakton qëllimin dhe mënyrën e realizimit të konsultimeve me palët e interesuara. Sipas metodologjisë, ministritë duhet të sigurojnë përfshirjen e palëve të interesuara gjatë gjithë procesit të VNR-së përkatësisht:

- në fazën e analizës së gjendjes dhe përcaktimit të problemit;
- përcaktimit të nevojës për futjen e rregullativës;
- në fazën e përcaktimit të zgjidhjeve të mundshme (pas vendosjes - themelore të zgjidhjeve të mundshme);
- në fazën e vlerësimit të zgjidhjeve të mundshme nga opsionet.¹⁰

Në lidhje me mënyrat, ministritë janë të obliguara që në fazën e planifikimit strategjik dhe vjetor të fillojnë me planifikimin e konsultimeve që gjatë procesit të VNR-së të mbledhin në kohë mendime nga palët e interesuara dhe të njëjtat t'i marrin parasysh gjatë përzgjedhjes së zgjidhjes optimale. Për lehtësimin e këtij procesi ministritë realizojnë planifikimin vjetor për VNR. Në këtë proces, propozim-ligjet të cilat i nënshtrohen VNR-së janë përcaktuar në Planin vjetor për realizimin e VNR-së. Çdo ministri është e obliguar në fillim të vitit të shpallë planin vjetor për VNR në të cilin njoftohen propozim-ligjet për të cilat do të përpilohet VNR-ja dhe, se kur do të ndodhë e njëjta. Në lidhje me konsultimet, në vetë planin janë dhënë edhe informacione për kohën dhe mënyrën e konsultimit për VNR.¹¹

Një nga obligimet e parashikuara për ministritë në metodologji është shpallja e pasqyrës së gjithë procesit dhe rezultatet e konsultimit në raportin për VNR-në, diçka që shumë rrallë respektohet nga ana e ministrive..¹²

¹⁰ Gazeta Zyrtare e RM-së 107/2013, fq. 27.

¹¹ Për më shumë informacione për rëndësinë e planeve për VNR si dhe për vështirësitë gjatë zbatimit të tyre, shiko: Marko Pankovski, Sfidat në planifikimin vjetor të VNR. IDSCS, shkurt 2018.

Njoftimi gjatë konsultimeve për VNR përfshihet në Raportin për vlerësimin e ndikimit të rregullativës. Forma dhe përmbajtja e raportit për VNR janë përcaktuar me vendimin e Qeverisë. Me këtë vendim përcaktohet se përveç pjesëve të tjera të raportit në të jepet edhe pasqyra e konsultimeve të realizuara. Sipas këtij vendimi raporti duhet të përmbajë:

- Palët e interesuara dhe mënyrën e përfshirjes;
- Pasqyrën e mendimeve të marra dhe të integruara;
- Mendime të cilat nuk janë marrë parasysh dhe pse.¹³

Konsultimet me palët e interesuara janë të përcaktuara në mënyrë më të hollësishme në *Udhëzimin për mënyrën e veprimit të punës së ministrisë në procesin e realizimit të ndikimit të rregullativës*.¹⁴ Në nenin 22 përcaktohen mënyrat për përfshirje dhe konsultimet me palët e interesuara:

- Kontroll publik i projekt-ligjit;
- Debate publike;
- Kërkesa për mendime me shkrim, vërejtje dhe sugjerime nga palët e interesuara;
- Pjesëmarrje në grupet e punës të formuara nga ana e ministrisë ose VRSM-ja;
- Takime me palët e interesuara;
- Debate publike.

¹² Pasqyra e zbatimit të këtij obligimi është dhënë më poshtë në tekst.

¹³ Gazeta Zyrtare e RM-së 106/2013 fq. 38.

¹⁴ Gazeta Zyrtare e RM-së 106/2013 fq. 51.

Neni 24 parashikon mbajtjen e debateve ku propozim-ligji hidhet në debat publik gjatë të cilit jepen detaje për informacione teknike për debatin të cilat shpallen në REKD dhe ueb-faqen e ministrive. Periudha për një debat të tillë publik duhet të jetë më e shkurtër se 20 ditë dhe varet nga tipi i konsultimit, ndërsa ftesat dorëzohen të paktën pesë ditë para mbajtjes së debatit publik. Sipas këtij udhëzimi, në nenin 25 është theksuar se nga procesi i zbatuar për VNR në Raportin për VNR futen:

- informacione për mënyrën e përfshirjes së palëve të interesuara;
- itë dhënat për palët e interesuara të cilat kanë marrë pjesë në proces;
- iqëndrimet e shprehura gjatë debateve publike, pikërisht mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e marra me shkrim ose të shpallura në REKD dhe portalin E-demokracia;
- imendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë përfshirë në propozim-ligj dhe mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që nuk janë pranuar nga ana e ministrisë dhe shpjegimi i arsyeve.¹⁵

Në mënyrë plotësuese në këto akte, ekzistojnë shumë dokumente dhe manualë të lëshuar nga MSHIA¹⁶ të cilat kanë si qëllim kahëzimin e implementimit të analizave të VNR-së dhe raportet si Udhëzimi për plotësimin e planit vjetor për vlerësimin e ndikimit të rregullativës në të cilin ndërmjet të tjerash jepen informacione bazë për konsultimet e parashikuara në vitin e ardhshëm, në bazë të programit vjetor për punën e Qeverisë. Më tej, *Udhëzimi për plotësimin e njoftimit për fillimin e procesit të përgatitjes së propozim-ligjit* ku njoftohet fillimi i procesit të konsultimeve duke përfshirë edhe mënyrat e konsultimit, si dhe *Udhëzimi për plotësimin e raportit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës*.

¹⁵ Ibid, fq. 53.

¹⁶ Është e nevojshme të theksohet „Manuali për palët e interesuara“ të shpallur nga MSHIA shpjegon procesin e përfshirjes së palëve të interesuara. Manuali është në dispozicion: http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/Manual%20za%20zasegnati%20faqe_3.pdf

3. Nevoja për raporte VNR në hije

Evidente është mungesa e informacioneve relevante në raportet e rregullta për Vlerësimin e ndikimit të rregullativës, që përgatisin ministrinë në suazat e kompetencave të tyre edhe pse situata po përmirësohet në vazhdimësi. Kjo mangësi pamundëson sjelljen e vendimeve të bazuara si dhe pjesëmarrje adekuate të organizatave të shoqërisë civile në procese, sepse ato nuk disponojnë me të dhëna mbi bazën e të cilave mund të përfshihen në to, të japin vlerësim, si dhe të kontribuojnë në mënyrë thelbësore.

Ideja e procesit paralel dhe plotësues të VNR-së është dykahëshe, kurse qëllimi i saj është të krijohen informacione të mjaftueshme që së pari do t'ju ndihmojnë deputetëve në Parlament të sjellin vendime (pasi propozim-ligji nga Qeveria të hyjë në procedurë parlamentare); si dhe të kontribuohet për pjesëmarrje të fuqizuar, adekuate të organizatave të shoqërisë civile në procesin e krijimit të politikave. Që organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë realisht në lidhje me propozimet, t'i argumentojnë dhe përfaqësojnë komentet dhe qëndrimet e tyre, atyre u duhen shumë më tepër burime për hulumtime sesa institucioneve përkatëse. Që këtu, zbatimi i drejtë i procesit të VNR-së, i bazuar në fakte dhe analiza mund ta fuqizojë pozicionin e organizatave të shoqërisë civile dhe t'ju sigurojë hapësirën e vërtetë gjatë konsultimeve.

"Ndjekja nga hijja", duhet të rezultojë me raporte (raporte në hije), përkatësisht forma alternative për VNR, që do të ofrojnë të dhëna, analiza të opsioneve të ndryshme mbi bazën e të cilave do të krijohet zgjidhja më adekuate ligjore, si dhe pasqyrë të ndikimeve sociale, ekonomike, administrative dhe ndikimeve të tjera, duke përfshirë edhe vlerësimin adekuat të shpenzimeve dhe të përfitimeve.

Ky raport jep pasqyrën e nivelit të zbatimit të procedurës për VNR dhe plotëson raportin VNR për Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Nëpunësit Administrativë gjë me të cilën plotëson të njëjtin me fokus në pjesën e konsultimeve me palët e interesuara.

Duke u nisur nga kjo, qëllimi i këtij dokumenti është depozitimi i informacioneve plotësuese dhe propozimeve nga palët e interesuara të konsultuara për zgjidhjen ligjore të propozuar me qëllim përfshirjen thelbësore të publikut në proces si dhe sjelljen e zgjidhjeve të informuara të bazuara mbi argumente dhe fakte. Në përputhje me burimet në dispozicion, depozitohet zgjidhje të mundshme të cilat adresojnë probleme të caktuara, për të nxitur kulturën e ndryshimeve dhe zbatimin me rigorozitet të proceseve në interes të qytetarëve.

Mënyra e realizimit

Bazë për procesin paralel për VNR-në e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e *Ligjit për Nëpunësit Shtetëror janë dokumentet e aksesueshme publikisht për VNR* (të bashkëngjitura në Regjistrin e Vetëm Elektronik Kombëtar të Dispozitave – REKD). Për të vërtetuar qëndrueshmërinë e zbatimit aktual të procesit të VNR-së do të analizohet nëse ndiqen dhe në çfarë mase ndiqen procedurat e përcaktuara dhe si veprohet gjatë vlerësimit të propozim-ligjit konkret. Në mënyrë plotësuese, në bazë të mangësive të përcaktuara, do të ofrohen zgjidhje paralele – përkatësisht do të identifikohet dhe përcaktohet problemi, do të krijohen grupet e fokusit për të përfshirë palët e interesuara, dhe në bazë të hulumtimeve të realizuara dhe mendimeve të marra – do të krijohen opsione. Analiza e anëve të fuqishme dhe të dobëta të opsioneve të ofruara do të japë bazën për zgjedhjen e propozimit më të volitshmëm, përkatësisht propozimit për zgjedhjen e opsionit më të mirë. Procesi do të realizohet mbi bazën e Metodologjisë aktuale për VNR¹⁷ të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe sipas manualëve për përgatitjen e VNR-së.¹⁸ Qëllimi është sigurimi i informacioneve të mjaftueshme që konsiderojmë se janë të domosdoshme gjatë sjelljes së zgjidhjeve të informuara. Që këtu, Raporti në hije ka tendencë të ndihmojë në zbatimin e mëtejshëm të VNR-së në lidhje me propozim ligjin konkret.

¹⁷ Metodologjia për NVR, Gazeta Zyrtare e RM-së, 107/ 13.

¹⁸ Manual për vlerësimin e ndikimit të rregullativës, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë 2013.

1. Përshkrimi i gjendjes në fushën përkatëse dhe përcaktimi i problemit

Propozues i Propozim *Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Nënpunësit Administrativë është Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë. Në dokumentet e disponueshme të REKD-së, në dosjen që ka të bëjë me propozim ligjin përfshihen:*

1. Njoftimi për fillimin e procesit të përgatitjes së Ligjit për Inspektoratin Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve (28/05/2019)

Respektimi i hapave për VNR

Gjatë procedurës së tanishme për VNR nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm të përcaktuara me Metodologjinë për VNR. **Përkatësisht, Ligji është pjesë e PVPQ-së për vitin 2019,¹⁹ por jo pjesë e Planit vjetor për realizimin e VNR-së për vitin 2019 të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, që në rastin konkret shfaqet si propozues i ligjit.** Obligimi për përgatitjen e propozim-ligjit del nga Konkluzioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo fazë është kyçe gjatë implementimit të procesit të VNR-së për vitin e ardhshëm gjë me të cilën mundësohet të përcaktohet cilat raporte VNR janë të nevojshme të përgatiten dhe sa më shumë që të jetë e mundur të parashikohet dinamika e rregullave në periudhën e ardhshme. Nga aspekti i implementimit të VNR-së, planifikimi duhet të përmirësojë shpërndarjen e materialeve të nevojshme dhe burimeve njerëzore. Plani vjetor mundëson tre përfitime kryesore në procesin e përgjithshëm të VNR-së. E para, me planin vjetor mundësohet kontrolli i propozim-ligjeve që do të përgatiten gjatë vitit që vjen. E dyta, përcaktohet dinamika e përgatitjes së VNR-së të propozim-ligjeve të theksuara me data të sakta kur do të zhvillohet procesi. E treta, jepet një pasqyrë e mënyrave të planifikuara të përfshirjes së palëve të interesuara.²⁰

¹⁹ https://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa_na_Vladata_2019.pdf

²⁰ Manual për paël të interesuara: Konsultime në procesin e krijimit të politikave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. MSHIA, shkurt 2014. Në dispozicion në: http://www.mioa.gov.mk/files/pdf/Priracnik%20za%20të%20interesuara%20faqja_3.pdf

Korniza kohore për VNR

Procesi për VNR ndaj subjekteve të jashtme duhet të fillojë me njoftimin për fillimin e procesit për përgatitjen e propozim-ligjit, dhe pastaj duhet të pasojnë të gjitha hapat për VNR deri në përgatitjen e Raportit për VNR dhe Propozim-ligjit. Sipas Metodologjisë për VNR, Plani vjetor për realizimin e VNR-së duhet të shpallet 15 ditë pas miratimit të Programit Vjetor për Punën e Qeverisë (PVPQ). Njoftimi për VNR shpallet 5 ditë para fillimit të procesit për VNR. Pastaj vijon procesi për VNR dhe kontroll publik i cili zgjat më së paku 20 ditë, palët e interesuara janë të ftuara 5 ditë para konsultimeve, ndërsa konsultimet zgjatin gjatë gjithë procesit. Draft-raporti për VNR shpallet 10 ditë para depozitimit të raportit pranë MSHIA-së, dhe pas marrjes së mendimit, propozim-ligji dhe propozim-raporti për VNR shpallen pasi të jenë miratuar nga ana e Qeverisë.

Në rastin konkret, korniza kohore nuk është respektuar sepse konsultimet me palët e interesuara nuk janë realizuar në afatin e parashikuar. Përgatitja e propozim-ligjit fillon një javë pas Njoftimit për fillimin e procesit, dhe planifikohet të përgatitet në dy javët e ardhshme (24/06/2019-17/07/2019).

Njoftimi për fillimin procesit për përpilimin e ligjit – në pjesën e përshkrimit të problemit nuk jepet përshkrim i shkurtër i problemit të rregullimit/derregullimit, por tregohet vetëm se Ligji silltet në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Një sqarim i tillë nuk mundëson një kontroll më të hollësishëm të nevojës për një zgjidhje të tillë ligjore, si dhe çfarë mungon në kornizën ligjore ekzistuese që tregon për nevojën e rregullimit plotësues në këtë fushë. Në njoftim nuk përcaktohet cilat palë të interesuara do të përfshihen në grupet e punës. Gjithashtu, nuk është përcaktuar nëse Qeveria apo ministria do të realizojë konsultimet nëpërmjet grupeve të punës.

Në lidhje me njoftimin për kontroll publik dhe debat publik, është theksuar vetëm që do të mbahet, pa informacione shtesë për tipin, përfshirjen dhe kohën e mbajtjes. Ky njoftim në mënyrë joadekuate njofton hapat e ardhshëm, dhe tregon për aktivitete tashmë të përfunduara në të cilat publiku ka mundësi të kufizuara për përfshirje. Me këtë shkelen haptazi parimet e hapjes dhe transparencës; qasjes dhe pjesëmarrjes; barazisë dhe trajtimit të drejtë.

²¹ Zakonisht PVPQ-ja miratohet në fund të vitit në vijim, ose fillimit të vitit të ri kalendarik.

Raporti VNR në hije²²

1. PËRSHKRIMI I GJENDJES NË FUSHËN PËRKATËSE DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT (DRAFT-RAPORTI I VNR)²³

1.1. PËRSHKRIMI I GJENDJES

Në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve (Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 07/2019) më saktë në nenin 20 të Ligjit është parashikuar sjellja e Ligjit për Inspektoratin Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve në cilësinë e organit në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në përputhje me të është propozuar tekst ligjor i njëjtë me qëllim rregullimin e mënyrës, procedurës dhe pozicionit të Inspektoratit për implementimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. QËLLIME TË PROPOZIM-RREGULLATIVËS

Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve është miratuar me qëllim monitorimin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

I njëjti Ligj garanton barazinë dhe paanshmërinë gjatë zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Me të njëjtin ligj gjithashtu janë parashikuar edhe parime të tjera të cilat vlejné gjatë kryerjes së mbikëqyrjeve inspektuese dhe funksionimit të inspektoratit në përgjithësi.

²² Kutitë me tekst janë ndërhyrje nga ana e IDSCS dhe CEA. Pjesët italik janë marrë në mënyrë integrale nga raporti i NVR-së.

²³ Ekstrakt i draft-Raportit për NVR për Propozim – Ligjin për Inspektoratin Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve: https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_ann_detail&itemid=JGG61CnNQ6lw6xKbPby1ww==

Ligji përcakton edhe kompetencën e Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve ku saktësisht janë theksuar kompetencat dhe çfarë lloj mbikëqyrjeje do të kryejë ky inspektorat.

Meqenëse bëhet fjalë për formimin e një organi të ri në përbërjen e Ministrisë së Drejtësisë, është parashikuar në mënyrë ligjore edhe vendosja organizative e inspektoratit. Ligji gjithashtu rregullon edhe vendosjen organizative të Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve. Si organe nëpërmjet të cilave Inspektorati kryen kompetencat janë drejtori i inspektoratit, inspektorët shtetërorë, si dhe shërbimi administrativ-teknik për kryerjen normale të punëve të inspektoratit.

Në të njëjtin Ligj janë theksuar edhe kushtet të cilat duhet të plotësohen për zgjedhjen e drejtorit dhe inspektorëve në kornizat e inspektoratit.

Në Ligj është përcaktuar edhe mënyra e kryerjes së inspektimit mbikëqyrës, më saktë mënyra se si kryhet inspektimi, si fillohet procedura inspektuese, cilat veprimtari ndërmerren gjatë mbikëqyrjes inspektuese, dhe si përfundon e njëjta.

Duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për procedurë kundërvajtjeje, në pjesën e kundërvajtjeve vlejné dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje.

Vlerësim: Sipas përshkrimit të disponueshëm të gjendjes mund të arrihet në konkluzionin se propozuesi nuk ka argumentuar shkaqet thelbësore për rregullimin plotësues në këtë sferë jashtë obligimit të parashikuar në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Propozuesi nuk u është referuar zgjidhjeve të mundshme të cilat nuk përfshijnë nevojën për plotësimin e ligjit.

Në pjesën e qëllimeve të propozim-rregullativës fokusi është vënë në sferën e veprimit të ligjit të propozuar, në vend të qëllimeve të rregulla-

▶ tivës. Përsëri, nuk përshkruhet se si korniza ekzistuese ligjore e parashikuar në pjesën e mbikëqyrjes inspektuese, nuk është e mjaftueshme për të justifikuar sjelljen e zgjidhjeve të reja ligjore.

Propozim: Është e nevojshme t'i kushtohet kujdes përshkrimit të qëllimeve thelbësore të propozim-ligjit dhe argumentimit me qëllim që të justifikohet nevoja për ngarkesën rregulluese shtesë përpos kornizës ligjore ekzistuese. Në mënyrë plotësuese, është e nevojshme të argumentohet pse nuk kalohet drejt ndryshimeve të kornizës ligjore relevante me qëllim adresimin e problemit, në vend të një zgjidhjeje ligjore plotësisht të reja.

3. ZGJIDHJE TË MUNDSHME (OPSIONE)

3.2 PËRSHKRIMI I ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME (OPSIONE) PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

Me zgjidhjen e lartpërmendur do të fuqizohet profesionalizmi dhe përgjegjësia e organeve shtetërore.

Vlerësim: Qëllimet e ligjit janë përcaktuar në mënyrë të qartë edhe pse të qëllimet nuk jepen ndryshimet në lidhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Propozim: Orientim drejt zgjidhjes së problemeve të ngjashme me ndërhyrje më të shpeshta dhe më të orientuara të cilat do të mundësojnë konsultime të thelluara të palëve të interesuara.

4. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË RREGULLAVE

NDIKIME TË MUNDSHME POZITIVE DHE NEGATIVE TË SECILIT NGA OPSIONET:

4.2 NDIKIME FISKALE

Ligji i propozuar shkakton implikime financiare plotësuese mbi Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 me vlerë të përgjithshme 7.423.000,00 denarë.

Ligji i propozuar shkakton implikime financiare në vlerë prej 7.423.000,00 denarë mbi buxhetin e RMV-së për vitin 2019. Pas kryerjes së rebalancit të buxhetit të RMV-së, vlera e planifikuar për Inspektoratin e Gjuhëve është zvogëluar për 4.464.000,00 denarë. Zvogëlimi i mjeteve është në pjesën e pagave dhe kompensimeve dhe ka të bëjë me vonesën e miratimit të Ligjit dhe fillimin me punë të Inspektoratit. Kjo vlerë është shpenzim direkt për përfituesin buxhetor dhe nuk duhet të vihet shenja e barazimit me implikimet fiskale. Diferenca ndërmjet vlerës së planifikuar për Paga dhe kompensime në buxhetin e RMV-së dhe kësaj vlere në rebalancin e buxhetit të RMV-së, është shtuar përsëri në propozim-buxhetin e RMV-së për vitin 2020. Në propozim-buxhetin e RMV-së për vitin 2020, janë planifikuar mjete me vlerë 10.423.000,00 denarë të dedikuara për Inspektoratin për Përdorimin e Gjuhëve. Rritja e vlerës së mjeteve në krahasim me vitin 2019 është në pjesën "Shërbime kontraktuese", "Blerje e pajisjeve dhe makinave" dhe "Blerje e mobilieve". Kjo vlerë është shpenzim direkt për përfituesin buxhetor dhe nuk duhet të barazohet me implikimet fiskale. Nga ana tjetër, ndikimet fiskale varen nga integrimi i suksesshëm i masave të parashikuara në ligjet e tjera të lidhura dhe aktet nënligjore, si dhe nga kapacitetet dhe aftësitë e të punësuarve në Inspektoratin për Përdorimin e Gjuhëve, për t'i implementuar me sukses, pikërisht për të vepruar në mënyrë barabartë dhe të paanshme gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese. Në afat të shkurtër kohor priten sfida të moderuara në lidhje me implementimin të cilat mund të merren parasysh: sfida rreth harmonizimit me ligjet e tjera, ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe materiale të administratës që të

implementojnë në mënyrë rigorozë dispozitat e Ligjit dhe në mënyrë plotësuese përfshirja kohore në pranimin e standardeve të reja, mund të krijojë pasiguri. Nëse të punësuarit në Inspektoratin për Përdorimin e Gjuhëve e implementojnë në mënyrë të barabartë, të njëjtë, të paanshme dhe transparente mbikëqyrjen inspektuese, në afat të gjatë kohor pritet rritje e numrit të institucioneve të cilat do të zbatojnë në mënyrë rigorozë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në RMV. Rreziqe ekzistojnë gjithmonë dhe nuk mund të eliminohen plotësisht prandaj është e nevojshme në fillim të vlerësohen rreziqet dhe pastaj të bëhen përpjekje për të zvogëluar ndikimin dhe intensitetin e tyre.

4.3 NDIKIME SOCIALE

Realizimi i inspektimit në terren ka potencial të ketë ndikime sociale në pjesën e rezistencës së subjekteve për të respektuar ligjin. Ekziston mundësia për politizimin e procesit të inspektimit, si dhe gjatë shqiptimit të gjobave. Në rajone të caktuara të vendit mund të shkaktojë ndikime sociale.

4.4 NDIKIME MBI MJEDISIN

Realizimi i inspektimit do të përfshijë udhëtime të shpeshta në terren me automjete zyrtare gjë me të cilën do të rritet emetimi i gazrave dalës në atmosferë.

4.5 NDIKIME ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIME –

Ka vlerën 7.423.000.00 denarë.

a) shpenzime për implementim

shpenzime kapitale të cilat në përputhje me propozim-buxhetin për vitin 2020 planifikohet të rriten me 1.500.00,00 denarë në krahasim me vitin 2019.

b) shpenzime për respektimin e rregullativës

shpenzime vijuese: paga dhe kompensime dhe mallra dhe shërbime. Pagat dhe kompensimet mbeten të pandryshuara në vitin 2020 përderisa mallrat dhe shërbimet janë planifikuar të rriten për 1.500.000,00 denarë për vitin 2020.

Vlerësim: Në këtë pjesë nuk janë analizuar të gjitha ndikimet që pjesërisht është rezultat i mungesës së konsultimeve me faktorët relevantë dhe palët e interesuara të cilët mund të tregojnë për ndikime të caktuara që propozuesi nuk i ka parashikuar.

Propozim: Është i nevojshëm shqyrtim i kujdesshëm i ndikimeve të caktuara, por edhe ndikimeve të mundshme të parashikuara me zgjidhjen ligjore. Përveç implikimeve juridike dhe financiare është e rëndësishme të mendohet edhe për ndikimet e tjera më të gjera parashikimi i të cilave është shumë kompleks, por megjithatë ato janë të rëndësishme dhe mund të ndikojnë në implementimin e ligjit dhe efekteve nga ai. Për këtë qëllim, është i nevojshëm konsultimi me një numër të gjerë faktorësh dhe palësh të interesuara të cilët mund të reagojnë për ndikimet e drejtpërdrejta dhe indirekte. Eksperiencia dhe ekspertiza e subjekteve të cilat u përfshinë në procesin e konsultimit do të kursejë resurse të rëndësishme në pjesën e analizës së ndikimeve sepse propozuesi do të ketë mundësi të njëjtat t'i marrë parasysh pa qenë nevoja nga ana tjetër që t'i zbatohet detyrimisht analizat me kapacitete e veta.

5. KONSULTIME

5.1 PALËT E INTERESUARA DHE MËNYRA E PËRFSHIRJES

- Mbulimi mediatik i informacionit për qytetarët
- Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve është hartuar nga një grup pune i përfaqësuesve të lartë të Ministrisë së Drejtësisë.
- Propozim-ligji është publikuar në REKD, gjë me të cilën çdo pale të interesuar i mundësohet të përfshihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me propozime dhe zgjidhje të tekstit të ligjit.

Me qëllim përfshirjen e një grupi më të gjerë të palëve të interesuara, IDSCS dhe CEA më 15.11.2019 mbajtën takim konsultues me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës të cilën e flasin të paktën 20%, e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe të shoqërisë civile. Gjatë takimit u shqyrtuan propozim-zgjidhjet dhe u fol për ndikimet potenciale. Në këtë raport të plotësuar të VNR-së, përveç propozimeve nga takimi i mbajtur më 15.11.2019 janë shtuar edhe mendimet e depozituara në REKD.

Mbetet vërejtja se shumica e organizatave civile konsultohen në një fazë më të avancuar të procesit dhe para tyre janë konsultuar pothuajse zgjidhje të gatshme. Mungon konsultimi në faza të detektimit të shkaqeve dhe propozimeve ligjore dhe zgjidhjeve.

5.2 PASQYRË E MENDIMEVE TË MARRA DHE TË INTEGRUARA

Në draft-raportin e VNR-së mungon pasqyra e mendimeve të marra dhe të integruara. Si rezultat i takimit konsultues, e bashkëngjitur është paraqitja tabelore me mendimet e marra nga ana e palëve të konsultuara.²⁴

Propozues	Propozim	Përgjigja nga institucioni
Përfaqësues i Institutit për Politikë Evropiane	Inspektorati mund të rregullohej në kornizat e zgjidhjeve të tjera ligjore	
	Duhet të parashikohet rreziku subjekti/organi të mos ketë mjete të mjaftueshme financiare për të zbatuar ligjin.	
	Afatin prej 15 ditësh për mospërputhjet të mendohet për ta zgjeruar (Neni 26, paragrafi 2)	
	Duhet të përcaktohet korniza përfundimtare e afatit nga neni 26, paragrafi 2 me qëllim që të jemi të sigurt sa do të zgjasë procedura.	Afatin maksimal duhet ta përcaktojë inspektori i cili do të shkojë në kontroll

²⁴ Konstatime nga takimi konsultues i organizuar nga IDSCS dhe CEA më 15.11.2019.

<p>► Përfaqësues i CDDD-së Prilep</p>	<p>Gjobat duhet të jenë më të ulëta për shkëljen e parë, dhe pastaj të rriten. Në këtë mënyrë do të pengohet shkëlja e qëllimshme nëse dikush mund ta paguajë gjobën.</p>	<p>Propozimi do të shqyrtohet</p>
<p>Komente të Fondacionit Shoqëri e Hapur Maqedonia</p>	<p>1. Vazhdon praktika e formimit të organeve të administratës shtetërore jashtë nga ZORODU</p> <p>ZORODU është sistem ligjesh dhe ndryshohet me shumicë të cilësuar 2/3. Ky ligj në thelb duhet të përshkruajë strukturën institucionale të shtetit. Nuk janë bërë ndryshime në këtë ligj, me të cilin do të parashikohet Inspektorati për Gjuhët si organ i Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë mënyrë vazhdohet me praktikën e formimit të organeve të administratës shtetërore me ligje individuale, praktikë e cila krijon rrezik nga themelimi i organeve me mandate të mbivendosura.</p>	<p>►</p>

▶	<p>Përveç kompetencave të përcaktuara qartë, është e panevojshme nevoja për përcaktimin e fushës së arsimit. (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Nëpunës Administrativë Neni 14, Neni 28 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik Neni 20-e, Neni 23-0)</p>	
	<p>2. (Nën supozimin se është e justifikuar ekzistenca e tij) Inspektorati duhet të jetë organ në përbërje të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, jo i Ministrisë së Drejtësisë</p> <p>Duke pasur parasysh natyrën e materies të cilën rregullon Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, me të cilin parashikohet formimi i Inspektoratit, nuk është e qartë pse inspektorati është parashikuar si organ i Ministrisë së Drejtësisë, dhe jo i Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, e cila është kompetente për politikat horizontale të sektorit publik. Supozimi është se Inspektorati për Procedurë Administrative për këto arsye kaloi nga organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë në organ të MSHIA-së.</p>	<p>Pjesët e parregulluara lënë një hapësirë të gjerë për interpretim dhe nëse diçka nuk është përcaktuar në Ligj, pastaj nuk mund të precizohet më tej në akt nënligjor.</p>



3. Formimi i një inspektorati të ri është në kundërshtim me angazhimin për optimizimin e sektorit publik, ndërmjet të tjerash nëpërmjet rritjes së shërbimeve inspektuese

MSHIA-ja në raportet e saj për avancimin në implementimin e Strategjisë për Reforma në Sektorin Publik, tregon se në bashkëpunim me USAID-in është përgatitur analiza²⁵ për riorganizimin dhe optimizimin e shërbimeve inspektuese, të cilat më tej duhet të shërbejnë si „bazë për implementimin e analizës horizontale funksionale “²⁶

²⁵ https://ener.gov.mk/files/propisi_files/report/101_1878296030%D0%94%D1%80%D1%83%D0%B3%D0%B8%20

²⁶ https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=4&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwjh982QtuzlAhXlx6YKHRZnAjqQFjADegQIBBAC&url=http%3A%2F%2Fmioa.gov.mk%2Fsites%2Fdefault%2Ffiles%2Fpbl_files%2Fdocuments%2Fpolugodishen_izveshtaj-01.11.2018.doc&usg=AOvVaw0YqDFeAuXk7NP7RqNHG3ci

	<p>Autorët e analizave rekomandojnë 28 shërbimet inspektuese ekzistuese (nën koordinimin e Këshillit Inspektues) të ristrukturohen në 12 shërbime inspektuese. Krijimi i shërbimeve të reja inspektuese në periudhën e riorganizimit vetëm do ta vështirësojë procesin. Në mënyrë plotësuese, me ndryshimin e legjislacionit ekzistues mund të ndryshojë sfera e veprimit e kompetencave të inspektorateve ekzistuese, në vend që të formohen të reja.</p>	
--	--	--

4. Kompetenca e Inspektoratit është e paqartë, sepse Ligji për Përdorimin e Gjuhëve është i paqartë

Nuk është e qartë për kë është krijuar obligimi për implementimin e dispozitave, për shembull te personat juridikë që kryejnë autorizime publike siç është parashikuar në nenin 1 (3), a përfshihen edhe subjektet private?! Nëse merret si referente lista e KOMSPI-së për atë se cili konsiderohet si person juridik me autorizime publike, Ligji përfshin nga Dhoma e Psikologëve deri në Butel, Shoqëri Aksionare për Shërbime Funerale.²⁷

Në mënyrë plotësuese, përfshirja është edhe më konfuzë me atë që është theksuar në nenin 2 (3) në të cilin veprojnë institucionet nga neni 1(3) si për shembull: procesi zgjedhor, arsimi, shkenca, shëndetësia, kultura, zbatimi i autorizimeve policore, veprimtari radio-difuzioni, shërbime noteriale, ekzekutime, objekte infrastruktorore, gjendja civile, dokumente personale, financa, ekonomi si dhe fusha të tjera?!

²⁷ <http://komspi.mk/2233/>



Ajo që krijon problem plotësues është shfrytëzimi inicial i përcaktimit të përgjithësuar në nenin 1(2) „gjuhë e cila flitet nga të paktën 20% e qytetarëve“ me sqarimin në kllapa se mendohet për gjuhën shqipe, që më vonë në tekst të përdoret vetëm një formulim i përgjithshëm. Teksti i ligjit bëhet akoma më konfuz kur rregullohet përdorimi i gjuhës së bashkësive jo-shumicë nën 20% ose kur rregullohet përdorimi i gjuhës në komuna ku më shumë se 20% janë bashkësi, të cilat nuk janë nga komuniteti shqiptar. Në përgjithësi ligji rregullon në mënyrë të pamjaftueshme përdorimin e gjuhës së komuniteteve të tjera jo-shumicë, për llogari të komunitetit shqiptar, dhe pretendon të jetë Ligj për Përdorimin e Gjuhëve (përkundër Ligjit për Përdorimin e Gjuhës Shqipe).

Gjithashtu nuk është e qartë në nenin 3, nëse i gjithë komunikimi në institucione duhet të zhvillohet në dy gjuhë, apo vetëm komunikimi me një funksionar të zgjedhur apo të emëruar.

	<p>5. Ka mundësi që sanksionet e parashikuara për mosrespektimin e detyrimeve për personat juridikë të jenë më të larta se shkelje të tilla ngjashme, të rregulluara me ligje të tjera.</p> <p>Duhet të kontrollohet nëse ka lëshime në vlerën e gjobës për persona juridikë në krahasim me gjobat për institucionet në ligje të tjera të parashikuara (është sfidë të përcaktohet çfarë është shkelje e ngjashme). Gjithashtu shqetëson fakti për hapësirën e vogël të gjobës, e cila nuk lejon të përcaktohet gjoba në varësi të seriozitetit të kundërvajtjes.</p>	
	<p>6. Nuk janë harmonizuar ligjet kryesore me këtë ligj</p> <p>Ligjet procedurale si Ligji për Procedurë Penale dhe Ligji për Procedurë Civile, nuk janë harmonizuar. Në mënyrë plotësuese, periudha e shkurtër për implementimin e ligjit me një volum të tillë, mos alokimi i mjeteve dhe burimeve njerëzore të nevojshme, tashmë krijon probleme.</p>	



Shembulli i fundit me rastin TNT është një ilustrim i mirë për problemet që mund t'i shkaktojë një ligj i cili është sjellë në mënyrë jo transparente, pa konsultime, ndërmjet të tjerash me institucionet të cilat duhet ta zbatojnë, me shpejtësi, pa marrë parasysh rreziqet. Në rastin konkret, ekziston rreziku që lënda të vjetërsohet, sepse avokati i ri i angazhuar në fazat e fundit të procedurës pretendon se nuk e flet mirë gjuhën maqedonase, dhe kërkon përkthimin e të gjithë lëndës (tani e gjithë procedura dhe arkivi duhet të jenë dygjuhëshe). Agjencia nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve supozoj se nuk është formuar që gjykata të shfrytëzojë resurset e saj, që pjesërisht shpjegohet me faktin se gjykata edhe sikur të donte të zbatonte obligimet nga Ligji për Zbatimin e Gjuhëve (mbikëqyrje nga LPP-ja), nuk i janë mundësuar kushte.

7. Mos-detektimi i sfidave në zbatimin e zgjidhjes ligjore paraprake para se të sillet Ligji i ri, vetëm e vështirëson edhe më tej implementimin

Duke pasur parasysh se ky ligj ka një përfshirje më të gjerë nga ai i mëparshmi, problemet me implementimin vetëm shumëfishohen. Megjithatë, përsëri, ky ligj nuk është sjellë në bazë të një vlerësimi real. Për shembull, analiza e implementimit të ligjit të mëparshëm, supozoj se do të tregojë se kemi administratë që nuk është e përgatitur të zhvillojë komunikim dygjuhësh, sepse shumica e të punësuarve aktual nuk i flasin të dy gjuhët, sidomos të punësuarit përfaqësues të bashkësisë etnike maqedonase. Për mua një zgjidhje e arsyeshme nënkupton në të ardhmen fuqia punëtore e cila do të angazhohet në administratën publike të jetë dygjuhëshe, përkatësisht kusht të jetë njohja e të dy gjuhëve, ndërsa e deritanishmja të trajnohet në mënyrë plotësuese. Gjobat e mëdha për mosrespektimin e ligjit siç janë parashikuar, nuk e zgjidhin për shembull këtë problem.

▶ Përfaqësuesi i Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup	Të specifikohet çfarë do të thotë 6 vjet eksperiencë në fushën përkatëse (neni 18)	
	Të ketë kusht kandidati të jetë vlerësuar në lidhje me përkushtimin e kaluar ndaj shoqërisë multikulturore	
Mendime të REKD-së – Gazmend Ramadani (26.07.2019)	Në lidhje me kushtet për zgjedhjen e inspektorëve do t'ju lutesha përveç Fakultetit Juridik dhe Ekonomik të vendoset edhe Fakulteti i Administratës Publike. Ky fakultet në të gjitha vendet e zhvilluara është më i rëndësishmi në organet shtetërore, ndërsa në shtetin tonë është i diskriminuar dhe nuk parashikohet askund.	

6. KONKLUZIONE DHE ZGJIDHJE E REKOMANDUAR

6.1 PASQYRË KRAHASUESE E NDIKIMEVE POZITIVE DHE NEGATIVE E ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME (OPSIONE)

Do të përmirësohet implementimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

6.2 RREZIQE NË IMPLEMENTIMIN E ÇDO ZGJIDHJEJE TË MUNDSHME (OPSIONE)

Nuk ka.

6.3 ZGJIDHJE E REKOMANDUAR ME ARSYETIM

Nëse Qeveria pranon tekstin e propozuar të ligjit, do të respektohet obligimi që del nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

7. IMPLEMENTIMI I ZGJIDHJES SË REKOMANDUAR

7.1 NEVOJA PËR NDRYSHIMIN E LIGJEVE DHE RREGULLATIVËS NËNLIGJORE NË FUSHËN PËRKATËSE OSE FUSHA TË TJERA TË NGJASHME

Nuk ka.

7.2 AKTE TË NEVOJSHME NËNLIGJORE DHE AFATI I SJELLJES SË TYRE

Aktet nënligjore do të sillen në një afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga sjellja e ligjit.

7.3 ORGANE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, ORGANE SHTETËRORE KOMPETENTE PËR IMPLEMENTIM

Ministria e Drejtësisë, Inspektorati Shtetëror për Përdorimin e Gjuhëve.

7.4 AKTIVITETE PËR SIGURIMIN E IMPLEMENTIMIT EFIKAS TË PROPOZIM LIGJIT.

Formi i stafit të Inspektoratit për përdorimin e gjuhëve të cilët kanë njohuri për ZOUP, si dhe obligimet të cilat dalin nga ligji. Trajnime të rregullta të inspektorëve dhe të të punësuarve në Inspektorat. Sigurimi i pyetjeve teknike për inspektimin mbikëqyrës.

8. NDJEKJA DHE VLERËSIMI

8.1 MËNYRA E NDJEKJES SË IMPLEMENTIMIT

Inspektorati sipas Ligjit është i obliguar çdo vit të depozitojë raport për punën e tij pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

8.2 VLERËSIMI I EFEKTEVE NGA PROPOZIM LIGJI DHE AFATET

Vlerësimi i efekteve të ligjit do të kryhet në dy faza: pas 12 dhe 24 muajsh nga hyrja në fuqi e Ligjit, mbi bazën e këtyre treguesve:

Pas 12 muajsh:

- Numri i kundërvajtjeve;
- Gjenerimi i shkaqeve më të shpeshta për kundërvajtje.

Pas 24 muajsh:

- numër i zvogëluar kundërvajtjesh;
- praktikë e avancuar për përdorimin e zgjidhjeve të parashikuara me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të cilat adresohen në këtë ligj.

Konkluzion

Në bazë të analizave të gjendjes aktuale mund të arrijmë në konkluzionin se ekzistojnë një sërë mangësish në procedurën për VNR gjë me të cilën nuk janë respektuar parimet e menaxhimit të mirë, veçanërisht sundimit të së drejtës, drejtësisë dhe ligjshmërisë.

Në lidhje me procedurën për VNR është i nevojshëm respektimi rigoroz i planit vjetor për VNR, transparenca dhe përfshirja gjatë konsultimeve si dhe respektimi i kornizës kohore. Për ata që janë përfshirë në procesin e VNR-së në administratën shtetërore, planifikimi u mundëson të planifikojnë në mënyrë adekuate detyrat që lidhen me VNR-në, që duhet të përgatitet vitin e ardhshëm dhe në cilën periudhë. Qasja në informacione të tilla përmirëson menaxhimin dhe shpërndarjen e obligimeve. Në lidhje me shoqërinë civile, planifikimi mundëson pasqyrë nëpërmjet së cilës organizatat e shoqërisë civile mund të intensifikojnë aktivitete të caktuara nëse ndryshimi i parashikuar në legjislacion dhe VNR-në e lidhur me të është pjesë e sferës së veprimit të tyre të punës.

Në draft-raportin për NVR nuk respektohen parimet e udhëheqjes strategjike dhe përgjegjësisë; efektivitetit dhe efikasitetit, dhe në masë më të madhe nuk mundësohet hapja dhe transparenca; llogaridhënia; qasja dhe pjesëmarrja; përfshirja; risitë, kreativiteti dhe hapja për ndryshime, barazia dhe trajtimi i drejtë.

Për përmirësimin e gjendjes është e nevojshme:

- mungon pasqyra e mendimeve të dhëna që është obligim i parashikuar me nenin 68-a të Rregullores për Punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- mungon shqyrtimi i më shumë opsioneve për zgjidhjen e problemit duke përfshirë këtu edhe nevojën për një ligj të ri në vend të ndryshimeve të zgjidhjeve aktuale ligjore;

- nuk janë parashikuar ndikime sociale;
- mungon një përshkrim më i hollësishëm i implikimeve financiare;
- përshkrim më i hollësishëm i rreziqeve dhe efekteve anësore gjatë implementimit;
- nuk janë parashikuar dhe përshkruar ndikimet që zgjidhjet do të kenë në terren gjatë implementimit duke pasur parasysh ndjeshmërinë politike të çështjes.

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË RREGULLATIVËS NË HIJE

-
RAPORT PËR VNR-
NË E LIGJIT PËR
INSPEKTORATIN
SHTETËROR PËR
PËRDORIMIN E
GJUHËVE - ME
FOKUS NË PROCESIN
E KONSULTIMEVE

-
DHJETOR, 2019

